

VENDIM
Nr.269, datë 12.3.2009

PËR MIRATIMIN E MËNYRËS SË PËRDORIMIT TË FONDEVE KUNDËRPARTI, TË MBLEDHURA NGA GRANTET JAPONEZE, PËR SEKTORIN E BUJQËSISË DHE TË USHQIMIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë“, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Fondet kundërparti të granteve japoneze, të mbledhura nga projekti “Rritja e prodhimit ushqimor” 2 KR, në shumë 320 000 000 (treqind e njëzet milionë) lekë, të derdhen në Buxhetin e Shtetit.
 2. Këto fonde të përdoren gjatë vitit 2009, me kredi pa interes, për rritjen e prodhimit agroindustrial.
 3. Me këto fonde të financohen:
 - a) Ndërtim dhomash frigoriferike;
 - b) Blerje dhe instalim linjash për përpunimin e qumështit;
 - c) Blerje dhe instalim linjash për përpunimin e fruta-perimeve.
 4. Masa e financimit të jetë në varësi të vlerës së linjës apo të makinerisë, por jo më shumë se:
 - a) 5 (pesë) milionë lekë, për dhomat frigoriferike;
 - b) 10 (dhjetë) milionë lekë për blerje dhe instalim linjash të përpunimit të qumështit;
 - c) 15 (pesëmbëdhjetë) milionë lekë për blerje dhe instalim linjash të përpunimit të fruta-perimeve.
 5. Vlera për dhomat frigoriferike, të linjave të përpunimit të qumështit e të fruta-perimeve, që do të financohen nga ky fond, të shlyhen, nga subjektet përfituese, me këste, si fonde kundërparti, pa interes dhe për një afat 7-vjeçar, duke filluar nga data e livrimit të fondit.
 6. Procedurat dhe mënyrat e administrimit të fondit (disbursimet dhe arkëtimet) të përcaktohen me udhëzim të përbashkët të Ministrit të Financave dhe të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit
 7. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

KOSTO PËR BAXHO QUMËSHTI ME KAPACITET 1500L/DITË
KOSTO INVESTIMI

Nr.	Emërtimi	Vlera (euro)		
1	Ndërtimi i objektit në parametrat e duhur higjieno-sanitarë	30.000		
2	Tanke ftohës + 2 pompa	7.000		
3	Kazan qumështi	5.000		
4	Dublikator	7.000		
5	Kaldajë	15.000		
6	Tavolina	2.000		
7	Centrifugë	500		
8	Banjë-mari	500		
9	Analizator qumështi	500		
10	Aksesor të tjerë	10.000		
11	Instalime	5.000		
	Totali I	82.500	10.800.000	Lekë

Mjete xhiro

Nr.	Përshkrimi	Njësia	Sasia (dita)	Sasia (muaj)	Sasia (vit)	Çmimi (lekë)	Vlera në vit (lekë)
1	Grumbullim qumështi						
	a) dimër	q	7	210	1.260	3.300	4.158.000
	b) verë	q	12	360	2.160	3.000	6.480.000
2	Paga	lekë	200	6.000	72.000		144.000
3	Sigurime						51.120
4	Naftë						171.000
5	Energji elektrike	lekë		900	10.800		10.800
6	Kripë	kg	8	246	2.952	7	20.664
7	Ingrediente	kg					70.000
8	Transport	lekë	1.000	30.000	360.000		360.000
	Totali II						11.465.584
Shuma totale I+II						22.265.584	

Tabela DS: 4 Suplement Mbështetja e brendshme: Republika e Shqipërisë Periudha për të cilën informohet: Vitet kalendarike, 2007-2009 Vlera <i>De minimis</i> e mbështetjes specifike për joproducte-Masat: Mbështetje e përgjithshme e vlefshme për prodhuesit për prodhimin bujqësor			
Vitet kalendarike fillojnë nga janari	Vlera e mbështetjes së përgjithshme të vlefshme për ujin deri 2007 dhe prodh. bujq. 2007-2009 (në 1.000 lekë) nga AMS DES: 4	Vlera totale e prodhimit bujqësor (në 1.000 lekë)	Niveli <i>De minimis</i> (5%)
2007	976.000 (460 ujitje +516 prodh. Bujq.)	207.356.721	10.367.836
2008	860.000	I pritshmi 215.858.346	10.792.917
2009	1.220.000 (900.000 prodh. Bujq. +320.000 fondi kundërpatri)	Parashikimi 218.016.292	10.900.846

PREVENTIV I NDËRTIMIT TË OBJEKTIT NJËKATËSH TË THERTOREVE PËR BAGËTI
TË TRASHA E TË IMTA

Nr.	Objektet	Totale	Bazë materiale (në lekë)	Shpërndarja strukturore
				Fuqi punëtore (në lekë)
1.	Punime ndërtimi të ndërtesës	12.438.032	7.937.773	4.500.259
2.	Muri rrethues	895.052	462.164	432.887
3.	Ndërtimi i vendit të rojës	166.714	131.916	34.798
4.	Ndërtimi i burgut të kafshëve	772.430	374.437	397.993
5.	Sistemimet e sheshit	3.119.588	2.634.700	484.889
6.	Dhoma frigoriferike	1.980.00	1.980.000	-
7.	Gropa septike	291.204	291.204	-
	Totali	19.663.020	13.812.195	5.850.825

Shënim.

Të gjitha llogaritjet e kostove si për bazën materiale, ashtu dhe fuqinë punëtore janë llogaritur si më poshtë:

1. Çmimet e tregut janë marrë si çmime bazë;
 2. Është përfshirë është struktura e shpenzimeve plotësuese prej 10%;
 3. Është përfshirë është struktura e fitimit të planifikuara prej 15%;
 4. Aplikimi i TVSH (Taskës mbi vlerën e shtuar) prej 20%.
- Përveç kësaj, në llogaritjet e kostove së fuqisë punëtore është kostoja për sigurimet shoqërore.